



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351-75

Dt. 13.02.2017

Prizren

**DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR**, me kërkesën e **DRC- Syndyz Kryeziu** nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Podrimës”** në bazë të nenit 3alineja 1 pikat 1.7 , 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 nenin 15, neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82,83,84,85 e në lidhje me nenin 86. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

- I. U LEJOHET **DRC – Syndyz Kryeziu** lejimin e ndërtimit të objektit – **shtëpi individuale** në rrugën **“Podrimës”**, në ngastrat kadastrale: **103-1**, të evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. **P-71813068-00103-1**, ZK Prizren, me etazhitet **P+0**.
  - Sipërfaqja e përgjithshme nën dhe rreth godinës është **586 m<sup>2</sup>( sipas kopjes së planit)**
  - Sipërfaqja e përgjithshme bruto e objektit është **75 m<sup>2</sup>.**
  - Sipërfaqja e përgjithshme neto për njësi të reja banimi është **62.60m<sup>2</sup>.**
  - Tarifa për 1m<sup>2</sup> është **4.19 €** & tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës
  - Lirohet nga pagesa e komunaleve konform aneks memorandumit të mirëkuptimit nr.108/16 dt. 04.10.2016.
- II. Hartimin e projektit për objektin investiv nga pika I e këtij aktvendimi për të gjitha fazat e ka bërë **DRC** ,dokumentacioni teknik është e tipit të **veçantë.**
- III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është situacioni i lokacionit me objekt sipas vijës rregulluese dhe asaj ndërtimore të përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo Drejtori, i cili do të shërbejë si bazë për nivelimin gjeodezik të objektit nga pika I e këtij Aktvendimi.
- IV. Investuesi është i obliguar:
  - Që të ruajë një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit, është dhënë kjo leje ndërtimi;
  - Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimit të kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;



- Të njoftoj Drejtorinë e inspeksionit për ditën e fillimit të punës, së paku 8 (tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të fiksimit dhe piketimit të shtrirjes së objektit brenda lokacionit.
- V. Investitori është i obliguar që 7 ditë pas përfundimit të objektit të paraqet kërkesën për kontrollimin teknik profesional te ky organ me qëllim të fillimit të procedurës për pajisje me Leje të përdorimit konform me nenin 49.50 dhe 51 të Ligjit për ndërtim nr. 2004/15
- Në rast se gjatë ndërtimit janë bërë ndryshime të projektit zbatues (gjatë realizimit të punimeve) investitori është i obliguar të prezantojë projektin e objektit në tërësi sipas zbatimit.
- VI. Leja e ndërtimit vlen 1 (një) vite nga dita e lëshimit me të drejtë vazhdimi edhe për një vit tjetër.
- VII. Punëkryesi është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte, ngase është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit ,kanalizimit, PTK, KEDC-it, Dukagjinit dhe avari tjera ti evitojë dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.

## A r s y e t i m

**Parashtruesi i kërkesës: DRC – Syndyz Kryeziu** nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Podrimës”** i është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes së ndërtimit për ndërtim të **objektit - shtëpi individuale**.

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara s’bashku me kërkesë vërtetohet se: që në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional të këtij organi.

Investitori s’bashku me kërkesë në shtojcë ka parashtruar këto dokumente të duhura:  
 - kopjen e planit; listën poseduese; aktvendimin mbi mbartjen e pronësisë me të cilët i ka zgjidhur marrëdhëniet pronëso-ro-juridike; aktvendim për rrënimin e objektit ekzistues; kushtet urbanistike; si dhe projektet.


Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave ma lartë të theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhanjen e leje se ndërtimit, si dhe lirimit nga pagesa e komunaleve konform aneks memorandumit të mirëkuptimit nr.108/16 dt. 04.10.2016.



**Udhëzimi juridik:** pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Hartuan:  
Bashkëpunëtorët profesional:



Afërdita Mormorina, inxhi.dipl.ark.



Arben Shala, jur.dipl.



DREJTORI:



Visar Islamaj

